

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.21.04.2021*

21.04.2021
Ora 13:37

RENDI I DITËS

Projektakti “Për shqyrtimin e raportit të Autoriteti të Medias Audiovizive të mbulimit të fushatës zgjedhore nga OSHMA-të për periudhën 4.04.2021 – 11.04.2021”.

PJESËMARRJA :

• **KQZ**

1.Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve **Z.Illirjan Celibashi**

2.Stafi KQZ: **Y.Merkaj, M.Koja, V.Ballgjini, E.Allushi**

• **Parti Politike: PD, LSI, PDIU**

Z. I. Celibashi: Mirëdita të gjithëve, fillojmë seancën publike për shqyrtimin e projektvendimit “Për raportin e Autoritetit të Medias Audiovizive të pasqyrimin të fushatës zgjedhore për periudhën 04.04.2021- 11.04.2021”. Projektvendimi “Për shtyrjen e auditimit për fondet e përfituara dhe shpenzuara gjatë vitit kalendarik 2020 nga partitë politike”. Projektudhezimi “Për përcaktimin e rregullave për raportimin financiar vjetor të partive politike, kontrollin dhe verifikimin e financimeve dhe shpenzimeve të tyre dhe mënyren e pagesës së audituesve”si dhe projektvendime “Për miratimin e vëzhguesve për vëzhgimin e zgjedhjeve të datës 25 prill 2021”. Fillojmë me pikën e parë të rendit të ditës.

Z. Y. Merkaj: Neni 80 dhe neni 81 i Kodit Zgjedhor parashikojnë rregullat e pasqyrimin të fushatës zgjedhore të subjekteve zgjedhore dhe edicionet informative në radiotelevizionin publik. Neni 83 i Kodit Zgjedhor përcakton se Këshilli Drejtues

*Zbardhi materialin audio
Jona DERVISHI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.21.04.2021*

i Radiotelevizionit Publik jo më vonë se 30 ditë para datës së zgjedhjeve, cakton minutazhin në dispozicion të çdo partie, në bazë të të dhënave të paraqitura nga KQZ-ja për partitë e regjistruara. Në bazë të nenit 84 të Kodit Zgjedhor përcaktohet se fushata zgjedhore në radiot dhe televizionet private, përcaktohen qartë rregullat e pasqyrimin të fushatës zgjedhore, minutazhi politik. Neni 85 i Kodit Zgjedhor shprehet për monitorimin e fushatës zgjedhore në media, i cili kryhet nga enti rregullator, në këtë rast Autoriteti i Medias Audiovizive, i cili ka detyrimin të pasqyrojnë gjetjet e veta nga procesi i monitorimit në raporte të detajuara dhe t’ia paraqesë KQZ-së për kompetencë. Raportet shoqërohen sipas rastit me propozime për masa administrative. Në raportin e dytë të dorëzuar pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, vendimi nr.56 datë 14.04.2021 të Autoritetit të Medias Audiovizive “Për shqyrtimin e raportit të monitorimit të mbulimit të fushatës zgjedhore nga OSHMA-të për periudhën 4 Prill 2021 – 11 Prill 2021, vërejmë se raporti përmbledh jo vetëm treguesit e monitoruar por edhe propozimet përkatëse për marrjen e masave administrative. Raporti përmbledhës përmban të dhëna mbi:

Depozitimin në AMA të përmbajtjeve të transmetuara nga OSHMA;

Kohën e monitorimit të OSHMA-ve në monitorim, për transmetimet e lajmeve;

Hapësirën për çdo aktor politik;

Kohën e monitorimit të OSHMA-ve në monitorim, për transmetimet e emisioneve;

Reklamat politike;

Raportin gjinor të mbulimit mediatic të kandidatëve.

Në lidhje me treguesin “Depozitimi i regjistrimeve në AMA”, në bazë të vendimit nr.56 datë, 14.04.2021 të AMA, rezulton se 12 subjekte audiovizive, nuk kanë respektuar detyrimin ligjor të mësipërm, pasi nuk kanë depozituar regjistrime për periudhën 4.04.2021 – 11.04.2021. AMA i propozon KQZ-së që të procedohet me marrje mase administrative, sipas përcaktimeve të Kodit Zgjedhor. Gjithashtu, AMA

*Zbardhi materialin audio
Jona DERVISHI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.21.04.2021*

informon se tre ofrues të shërbimeve mediatike kanë depozituar regjistrime jo për të gjitha ditët e kësaj periudhe dhe për këtë arsye AMA i propozon KQZ-së t'u tërheqë vëmendjen këtyre OSHMA-ve, për respektimin e plotë të këtij detyrimi. Në lidhje me treguesin "Monitorimi i edicioneve informative", në mbështetje të nenit 81 të Kodit Zgjedhor parashikohet se në minutazhin politik të edicioneve informative, radiotelevizioni publik është i detyruar të zbatojë raporte kohore të barabarta për të gjitha partitë parlamentare. Në tabelën e paraqitur pasqyrohet koha e plotë e subjekteve politike: PD, PS, LSI, PSD në edicionet informative. Referuar të dhënave të tabelës vihet re se minutazhi politik në edicionet informative ka shpërndarje të pabarabartë dhe jo në përputhje me nenin 81 të Kodit Zgjedhor. Si rrjedhojë, AMA i propozon KQZ-së për 27 OSHMA-të e listuara në tabelën nr.1, të bëjnë kompensimin me kohë transmetimi në edicionet e lajmeve, për balancim. Gjithashtu, në lidhje me këtë tregues, AMA ka identifikuar TV Bulqiza që ka përfshirë në përmbajtjet e saj audiovizive dhe transmetimin e edicioneve informative të një OSHMA-je tjetër. Për këtë rast AMA i propozon KQZ-së që t'i drejtohet OSHMA-së për ndërprerjen e menjëhershme të transmetimeve të përmbajtjeve informative të një OSHMA-je tjetër. Në lidhje me treguesin "Transmetimi i reklamave politike" rezulton se 7 OSHMA kanë transmetuar reklama politike të cilat nuk janë qartësisht të identifikueshme se cili është subjekti porositës. Për këtë tregues AMA i propozon KQZ-së t'u tërheqë vëmendjen OSHMA-ve për mos përsëritjen e një shkelje të tillë. Gjithashtu, në zbatim në nenit 84 , pikat 5 dhe 6 të Kodit Zgjedhor, OSHMA-të të cilat nuk kanë respektuar këtë tregues rezulton se 8 OSHMA nuk e kanë respektuar këtë kërkesë të Kodit Zgjedhor prandaj AMA i propozon KQZ-së t'u ndërpresë transmetimin e reklamave politike jashtë intervaleve kohore të përcaktuara nga Kodi Zgjedhor. AMA ka konstatuar raste të transmetimit të reklamës politike brenda edicionit të lajmeve nga OSHMA-të si më poshtë:

*Zbardhi materialin audio
Jona DERVISHI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.21.04.2021*

TV Klan News në datat: 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11 prill 2021;

TV 6+1 në datën 5 prill;

TV Apollon 05 prill 2021.

Në këtë mënyrë, AMA i propozon KQZ-së t'i kërkojë OSHMA-ve të ndërpresin transmetimin e reklamave politike brenda edicioneve të lajmeve. Referuar nenit 84 pika 5, të Kodit Zgjedhor, 11 subjekte audiovizive kanë tejkaluar kufirin e kohës që parashikon Kodi Zgjedhor për një subjekt politik konkurrues, që është përcaktuar deri në 90 minuta, pasi ka transmetuar më shumë minuta reklamë politike për partitë politike PS dhe PD. Të njëjta subjekte audiovizive kanë tejkaluar kufirin e kohës që parashikon Kodi Zgjedhor për një subjekt politik konkurrues për partinë politike LN, e cila sipas vendimit të Komisionerit e ka 10 minuta për gjithë fushatën zgjedhore. Për këtë arsye, AMA i propozon KQZ-së t'i kërkojë subjekteve audiovizive të ndërpresin transmetimin e reklamës politike për këto subjekte zgjedhore. Për sa i takon vlerësimin gjinor të përmbajtjeve të transmetuara nga OSHMA-të për fushatën elektorale, përveç operatorëve RTSH1, TV Klan, Top Channel, Euronews dhe One TV Vlora, të cilët e kanë pasqyruar në balancë, pjesa tjetër ka disbalancë për këtë tregues. Për këtë AMA i propozon KQZ-së t'i tërheqë vëmendjen OSHMA-ve të cilat nuk e kanë respektuar këtë kriter. Në lidhje me monitorimin dhe respektimin e kërkesave të nenit 78 të Kodit Zgjedhor, publikimi i sondazheve zgjedhore, janë identifikuar 2 OSHMA (Syri Tv dhe Report Tv) të cilat nuk kanë respektuar detyrimin ligjor për të dhënë informacion të detajuar mbi publikimin e rezultateve të sondazheve në lidhje me emrin e organizatorit, numrin e personave të intervistuar, probabilitetin e gabimit, si dhe periudhën e realizimit të sondazhit. Për këtë tregues, AMA i propozon KQZ-së t'i tërheqë vëmendjen OSHMA-ve të respektojnë të gjitha kërkesat e nenit 78 të Kodit Zgjedhor. Për sa më sipër keni për shqyrtim dhe miratim Raportin e AMA-s, faleminderit!

*Zbardhi materialin audio
Jona DERVISHI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.21.04.2021*

Z. I. Celibashi: Faleminderit, përfaqësuesit e partive politike? Përfaqësuesi i Partisë Demokratike!

Z. L. Nuraj, përfaqësues i PD-së: Faleminderit, pasi jemi njohur edhe ne me raportin e dorëzuar nga AMA si dhe me projektdraftin e vendimit. Ne vëmë re të njejtën situatë të përsëritur si gjatë gjithë fushatës zgjedhore nga të gjithë operatorët televizivë, si ata kombëtarë dhe ato lokalë, të cilët nuk kanë ruajtur aspak balancën e minutazhit, apo kohën e barabartë në lidhje me kohën që duhet t'u jepnin subjekteve politike, aq më tepër subjektit politik që ne përfaqësojmë Partinë Demokratike. Siç shihet në të gjitha tabelat dhe pasqyrat që janë dorëzuar, Partia Demokratike, rezulton në një kohë shumë të mangët si në reklamat e kandidatëve apo të subjektit të saj, si në të gjitha rubrikat e lajmeve, apo emisioneve televizive. Vihet re që këtë qëndrim kanë mbajtur të gjitha televizionet. Nuk kemi ndonjë diferencim sipas televizioneve të ndryshme dhe kjo duket që është bërë me një vetëdije të plotë dhe është një politikë e qartë e të gjithë këtyre operatorëve. Disa të nxitur ndoshta dhe nga vetë politikat që ata ndjekin, apo mendojmë edhe nga disa presione të tjera ku të cilët nuk kanë respektuar aspak minutazhin dhe për më tepër sasi të e minutazhit të cilat kanë ngrënë, apo sugjerohen për t'u kompensuar, janë të një numri shumë të madh. Këto kalojnë limitet e sugjeruara nga ligji dhe Kodi Zgjedhor. Nga sa po shohim, kjo situatë ka mbetur e njejtë edhe sot që jemi gati dy ditë para mbylljes së fushatës elektorale. Pavarësisht edhe pas sugjerimeve që ka bërë AMA në vazhdimësi nuk është se kanë vlejtur. Pavarësisht propozimeve që ka bërë për disa televizione lokale, të cilat mund të jenë të papërfillshme në lidhje me gjithë tabelën e televizioneve të cilat operojnë në Tiranë, apo kombëtare, për disa ka referuar masa administrative me gjobë dhe për disa të tjera, ka sugjeruar thjesht,

*Zbardhi materialin audio
Jona DERVISHI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.21.04.2021*

tërheqjen e vëmendjes. Do të kërkonim që Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, duke qenë se është njohur me këtë problematikë prej disa herëve, në bazë të raporteve të tyre, të aplikonte masa administrative më të ashpra edhe në gjobitjen e disa televizioneve të tjera, duke pasë parasysh dhe tabelat që ju janë dorëzuar nga AMA, faleminderit.

Z. I. Celibashi: Faleminderit, përfaqësuesi i Lëvizjes Socialiste për Integrim!

Z. K. Kolndreaj, përfaqësues i LSI-së: Jemi dakord!

Z. I. Celibashi: Përfaqësuesi i Partisë për Drejtësi Integrim dhe Unitet!

Z. Sh. Sulo, përfaqësues i PDIU-së: Dakord!

Z. I. Celibashi: Faleminderit! Atëherë, meqenëse nuk kemi diskutime të tjera në lidhje me përmbajtjen e këtij projektakti edhe në konsiderim pjesor të atyre që prezantoi përfaqësuesi i Partisë Demokratike, bazuar në nenin 19, pika 1, shkronja “n” dhe pika 2, neni 78, 80, 81, 83, 84, 85 dhe neni 171, pika 1, të Kodit Zgjedhor si dhe vendimit nr.2, datë 30.01.2021 të Komisionit Rregullator “Për miratimin e metodologjisë së monitorimit të medias audio dhe audiovizive”,

Vendos:

Marrjen e masës administrative, gjobë në masën 5000 (pesë mijë) lekëve, pasi nuk kanë depozituar regjistrime për periudhën 4.04.2021 – 11.04.2021, për ofruesit e shërbimit mediatik audioviziv, si më poshtë vijon: TV Channel 1, TV Kopliku, TV Antena Nord, TV Klaudiana, TV Channel 7, TV Jug, TV Gold, TV Glob, TV Puka, TV 4.

*Zbardhi materialin audio
Jona DERVISHI*



**Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.21.04.2021**

T'u tërheqë vëmendjen, për respektimin e plotë të detyrimit ligjor për të depozituar pranë AMA-s regjistrime për periudhën 4.04.2021 – 11.04.2021, për operatorët:

TV Sot, TV Adria Med, TV Antena Nord, TV Channel 7 dhe TV Kukësi.

Pika 3. Të bëjnë kompensim me kohë transmetimi në edicionet e lajmeve për balancim, operatorët e mëposhtëm:

RTSH 1	65 min PD, 87 min LSI, 91 min PSD;
RTSH 2	13 min PD, 22 min LSI, 26 min PSD;
TV Klan	148 min PD, 147 min LSI, 147 min PSD;
TV Top Channel	34 min PD, 53 min LSI, 54 min PSD;
TV Vizion Plus	53 min PD, 74 min LSI, 91 min PSD;
RTSH 24	76 min PD, 61 min LSI, 64 min PSD;
Klan Plus	47 min PD, 41 min LSI, 50 min PSD;
Klan News	352 min PD, 277 min LSI, 305 min PSD;
Top News	38 min PD, 79 min LSI, 81 min PSD;
Kanal 7	25 min PD, 30 min LSI, 40 min PSD;
News 24	16 min PD, 52 min LSI, 102 min PSD;
ABC News	11 min PD, 40 min LSI, 56 min PSD;
RTV Ora	4 min PD, 35 min LSI, 48 min PSD;
Report TV	229 min PD, 150 min LSI, 200 min PSD;
TV Scan	64 min PD, 58 min LSI, 87 min PSD;
TV Ora News	19 min PD, 35 min LSI, 64 min PSD;
TV Shijak	106 min PS, 33 min LSI, 183 min PSD
Euronews Balkans	13 min PD, 92 min LSI, 123 min PSD;
Fax News	45 min PD, 37 min LSI, 53 min PSD;
Syri TV	55 min PS, 89 min LSI, 127 min PSD;
RTSH Gjirokastra	52 min PD, 43 min LSI, 109 min PSD;

**Zbardhi materialin audio
Jona DERVISHI**



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.21.04.2021*

TV Mati	31 min PS, 15 min LSI, 15 min PSD;
Star Plus	8 min PS, 20 min LSI, 20 min PSD;
TV 6+1	430 min PD, 320 min LSI, 299 min PSD;
TV Best	5 min PD, 26 min LSI, 47 min PSD;
One Tv Vlora	172 min PD, 111 min LSI, 141 min PSD;
Belsh Tv	25 min LSI, 25 min PSD.

Pika 4. Mospërsëritjen e transmetimit të reklamave politike të cilat nuk kanë identifikuar qartë subjektin porositës për operatorët e mëposhtëm:

- TV Klan data 06 prill 2021;
- TV Top Channel data 06 prill 2021;
- TV Vizion Plus data 10 prill 2021;
- TV Fax News data 06 prill 2021;
- Klan Plus data 06 prill 2021;
- Klan News data 06 prill 2021;
- Tv 6+1 data 07, 08, 09,10,11 prill 2021.

Pika 5. AMA të vendosë në dispozicion operatorëve të përcaktuar në pikën 4 të këtij vendimi, të dhënat ditore ku janë konstatuar shkeljet, brenda 24 orëve nga miratimi i këtij vendimi.

Pika 6. Ndërprerjen e transmetimit të reklamave politike jashtë intervaleve kohore të përcaktuara, për operatorët si më poshtë vijon:

- TV Top Channel data 04 prill 2021;
- TV News 24 data 11 prill 2021;
- TV Shijak datat 04-11 prill 2021.

Janë shkeljet për këto data, apo jo? Se urdhërimi është që nga momenti i marrjes së vendimit dhe në vijim, apo jo?! Dakord!

TV Kanal 7, One Tv Vlora, TV 6+1, TV Apollon, TV Best (datat 10-11 prill 2021)

*Zbardhi materialin audio
Jona DERVISHI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.21.04.2021*

Pika 7. AMA t'u vendosë në dispozicion operatorëve të përcaktuar në pikën 6 të këtij vendimi, të dhënat ditore ku janë konstatuar shkeljet, brenda 24 orëve nga miratimi i këtij vendimi.

Pika 8. Të ndërpritet menjëherë transmetimi i reklamave politike brenda edicioneve të lajmeve për televizionet si më poshtë: TV Klan News, TV 6+1, TV Apollon. Për shkeljet respektivisht nga data 4 deri në 11 TV Klan News, datën 5 për TV 6+1 dhe TV Apollon për datën 5. Gjithashtu operatorët e mëposhtëm të ndërpresin menjëherë të transmetimin e reklamës politike për subjektet zgjedhore të cilët e kanë tejkaluar kohën për Tv Klan, Top Chanel, Klan Plus, Klan News, News 24, ABC News, Report TV, TV Shijak, Fax News, One Tv Vlora, Tv 6+1.

T'u tërheqë vëmendjen dy operatorëve, Syri Tv dhe Report Tv, për respektimin e plotë të detyrimit ligjor për të dhënë informacion të detajuar mbi publikimin e rezultateve të sondazheve në lidhje me emrin e organizatorit, numrin e personave të intervistuar, probabilitetin e gabimit, si dhe periudhën e realizimit të sondazhit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda tre ditëve në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve.

Vendimi nr.257

*Zbardhi materialin audio
Jona DERVISHI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.21.04.2021*

**21.04.2021
Ora 14:00**

RENDI I DITËS

Projektvendim “Për shtyrjen e auditimit për fondet e përfituara dhe shpenzuara gjatë vitit kalendarik 2020 nga partitë politike”.

PJESËMARRJA :

• **KQZ**

1.Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve Z.Illirjan Celibashi

2.Stafi KQZ: Y.Merkaj, M.Koja, V.Ballgjini, E.Allushi

• **Parti Politike: PD, LSI, PDIU**

Z. I. Celibashi: Vazhdojmë me pikën tjetër të rendit të ditës.

Z. Y. Merkaj: Neni 23 i Kodit Zgjedhor, parashikon mënyrën e dorëzimit si dhe përmbajtjen e informacionit të hollësishëm të raporteve financiare vjetore nga partitë politike. Neni 23/2 i Kodit Zgjedhor, përcakton mënyrën e caktimit të ekspertëve kontabël si dhe kohën e mbylljes së procedurës së verifikimit dhe dorëzimin e raporteve financiare. Në zbatim të nenit 19, pikat 1, shkronja “dh”, të Kodit Zgjedhor si dhe neni 23, 23/1, 23/2, 23/4 dhe 24 të ligjit për partitë politike, i ndryshuar si dhe bazuar në pretendimet e ngritur nga financierët e Partisë Socialiste dhe Partisë Demokratike si dhe Partisë Lëvizja Socialiste për Integrim, është hartuar projekt-vendimi “Për shtyrjen e auditimit të fondeve të përfituara dhe shpenzuara gjatë vitit kalendarik 2020 nga partitë politike”. Qëllim i këtij projektvendimi është shtyrja e auditimit financiar vjetor deri në muajin shtator 2021, për fondet e përfituara dhe shpenzuara gjatë vitit kalendarik 2020 për partitë



**Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.21.04.2021**

politike, për arsye se periudha e auditimit vjetor këtë vit korespondon me muajin e fushatës zgjedhore që është deri në datën 25 Prill 2021. Financierët e partive politike janë të ngarkuar me raportet për zgjedhjet dhe për fushatën zgjedhore, për këtë arsye nuk ia arritën dot që t'i dorëzojnë këto raportet. Kemi përgatitur, hartuar projektvendimin e mësipërm dhe ia paraqesim Komisionerit për shqyrtim dhe miratim, faleminderit.

Z. I. Celibashi: Po përfaqësuesit e partive politike kanë ndonjë gjë?

Z. L. Nuraj, përfaqësues i PD-së: Gjithashtu dhe ne duke vlerësuar dhe shtyrja e auditimit duke vlerësuar se shtyrja e auditimit financiar për në periudhën shtator 2021 siç propozohet në akt “Për fondet e përfituara dhe shpenzuara për vitin kalendarik nga partitë politike për vitin 2020”. Për sa i përket periudhës së auditimit që përkon edhe me zgjedhjet të 25 prillit 2021, gjendemi dakord me propozimin nga akti që auditimi të kryhet në periudhën shtator 2021, faleminderit.

Z. I. Celibashi: Faleminderit, përfaqësuesi i Lëvizjes Socialiste për Integrim?

Z. K. Kolndreaj, përfaqësues i LSI-së: Jemi dakord me propozimin.

Z. I. Celibashi: Përfaqësuesi i PDIU-së?

Z. Sh. Sulo, përfaqësues i PDIU-së: Dakord.

**Zbardhi materialin audio
Valbona DUSHI**



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.21.04.2021*

Z. I. Celibashi: Atëherë idea është që këtë auditim do ta kryejmë gjatë muajit shtator, kjo është idea? Nga datë 1 shtator deri në datën 30. E kam fjalën në të shkruar shtator 2021 është në rregull. Gjatë këtij muaji kjo është ide?

Znj.V.Ballgjini: Po.

Z. I. Celibashi: Faleminderit, miratohet dhe ky projektvendim sipas të cilit, auditimi i fondeve do të kryhet për fondet që partitë kanë marrë për vitin kalendarik për vitin 2020 gjatë muajit shtator të vitit 2021.

Vendimi nr.258



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.21.04.2021*

**21.04.2021
Ora 14:03**

RENDI I DITËS

*Projektvendim “Për miratimin e vëzhguesve afatshkurtër dhe përkthyesve të
Ambasadës Japoneze, Britanike, Franceze, Turke, Suedeze, Hungareze, të
Republikës së Kosovës dhe Zviceriane, për vëzhgimin e zgjedhjeve për Kuvendin
e Shqipërisë, të datës 25 prill 2021”.*

PJESËMARRJA :

- **KQZ**
1.Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve **Z.Ilirjan Celibashi**
2.Stafi KQZ: **Y.Merkaj, M.Koja, V.Ballgini, E.Allushi**
- **Parti Politike: PD, LSI, PDIU**

Z.I.Celibashi: Vazhdojmë me vëzhguesit.

Z.Y.Merkaj: Ambasada Japoneze ka paraqitur kërkesë për akreditimin e 3 vëzhguesve afatshkurtër dhe 2 përkthyesve. Ambasada Franceze ka paraqitur kërkesë për akreditimin e 7 vëzhguesve afatshkurtër dhe 5 përkthyesve. Ambasada Britanike ka paraqitur kërkesë për akreditimin e 10 vëzhguesve afatshkurtër dhe 11 përkthyesve. Ambasada Turke ka paraqitur kërkesë për akreditimin e 1 vëzhguesi afatshkurtër dhe 1 përkthyesi. Ambasada Suedeze ka paraqitur kërkesë për akreditimin e 2 vëzhguesve afatshkurtër dhe 3 përkthyesve. Ambasada Hungareze ka paraqitur kërkesë për akreditimin e 2 vëzhguesve. Ambasada e Republikës së Kosovës ka paraqitur kërkesë për akreditimin e 5 vëzhguesve afatshkurtër. Ambasada Zviceriane ka paraqitur kërkesë për akreditimin e 3 vëzhguesve



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.21.04.2021*

afatshkurtër dhe 3 përkthyesve. Dokumentacioni është në përputhje me kriteret e përcaktuara në nenin 6 të Kodit Zgjedhor.

Z.I.Celibashi: Miratohet kërkesa e Ambasadës Japoneze për akreditimin e 3 vëzhguesve afatshkurtër dhe 2 përkthyesve.

Miratohet kërkesa e Ambasadës Franceze për akreditimin e 7 vëzhguesve afatshkurtër dhe 5 përkthyesve.

Miratohet kërkesa e Ambasadës Britanike për akreditimin e 10 vëzhguesve afatshkurtër dhe 11 përkthyesve.

Miratohet kërkesa e Ambasadës Turke për akreditimin e 1 vëzhguesi afatshkurtër dhe 1 përkthyesi.

Miratohet kërkesa e Ambasadës Suedeze për akreditimin e 2 vëzhguesve afatshkurtër dhe 3 përkthyesve.

Miratohet kërkesa e Ambasadës Hungareze për akreditimin e 2 vëzhguesve.

Miratohet kërkesa e Ambasadës së Republikës së Kosovës për akreditimin e 5 vëzhguesve afatshkurtër.

Miratohet kërkesa e Ambasadës Zviceriane për akreditimin e 3 vëzhguesve afatshkurtër dhe 3 përkthyesve.

Vendim nr.259

Zbardhi materialin audio

Silvi SINO



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.21.04.2021*

21.04.2021
Ora 14:03

RENDI I DITËS

Projektvendim “Për miratimin e vëzhguesve afatshkurtër dhe përkthyesve të Delegacionit të Bashkimit Evropian në Shqipëri dhe vëzhguesve afatshkurtër të NDI Albania, për vëzhgimin e zgjedhjeve për Kuvendin e Shqipërisë, të datës 25 prill 2021”.

PJESËMARRJA :

- **KQZ**
 - 1.Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve **Z.Illirjan Celibashi**
 - 2.Stafi KQZ: **Y.Merkaj, M.Koja, V.Ballgjini, E.Allushi**
- **Parti Politike:** **PD, LSI, PDIU**

Z.I.Celibashi: Vazhdojmë me vëzhguesit.

Z. Y. Merkaj: Delegacioni i Bashkimit Evropian në Shqipëri ka bërë kërkesën për akreditimin e 14 vëzhguesve. Gjithashtu NDI Albania ka kërkuar për akreditim të 5 vëzhguesve.

Z.I.Celibashi: Miratohet kërkesa e Delegacionit të Bashkimit Evropian për akreditimin e 14 vëzhguesve.

Miratohet kërkesa e NDI Albania për akreditimin e 5 vëzhguesve.

Vendimi nr. 260

*Zbardhi materialin audio
Silvi SINO*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.21.04.2021*

**21.04.2021
Ora 14:03**

RENDI I DITËS

Projektvendim “Për miratimin e gazetarëve dhe operatorëve të medias ATV, Bulgarian News Agency, ABC News dhe Turkey Radio and Television Corporation (TRT), për vëzhgimin e zgjedhjeve për Kuvendin e Shqipërisë, të datës 25 prill 2021”.

PJESËMARRJA :

- **KQZ**
 1. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve **Z. Ilirjan Celibashi**
 2. Staf i KQZ: **Y. Merkaj, M. Koja, V. Ballgjini, E. Allushi**
- **Parti Politike: PD, LSI, PDIU**

Z.I. Celibashi: Vazhdojmë me vëzhguesit e tjerë.

Z.Y. Merkaj: Media AL TV ka kërkuar akreditimin e 6 gazetarëve si dhe zonat e vëzhgimit të tyre. Bulgaria News Agency i ka paraqitur Komisionit Qendror të Zgjedhjeve kërkesën për akreditimin e 1 gazetari. ABC News ka kërkuar akreditimin e 8 gazetarëve dhe operatorëve si dhe zonat e vëzhgimit. Turkey Radio and Television (TRT) ka paraqitur kërkesën për akreditimin e 3 gazetarëve dhe operatorëve si dhe zonat e vëzhgimit të tyre. Dokumentacioni është në përputhje me nenin 6 të Kodit Zgjedhor.

Z. I. Celibashi: Miratohet kërkesa e Televizionit Media AL TV për akreditimin e 6 gazetarëve si dhe zonat e vëzhgimit të tyre.

Miratohet kërkesa e Bulgaria News Agency për akreditimin e 1 gazetari.

**Zbardhi materialin audio
Silvi SINO**



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.21.04.2021*

Miratohet kërkesa e TV ABC News për akreditimin e 8 gazetarëve dhe operatorëve si dhe zonat e vëzhgimit.

Miratohet kërkesa e Turkey Radio and Television (TRT) për akreditimin e 3 gazetarëve dhe operatorëve si dhe zonat e vëzhgimit të tyre.

Vendimi nr.261

*Zbardhi materialin audio
Silvi SINO*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.21.04.2021*

21.04.2021
Ora 14:03

RENDI I DITËS

Projektvendim "Për një shtesë në vendimin nr. 151, datë 16.03.2021, "Për miratimin e vëzhguesve afatgjatë të Misionit të OSBE/ODIHR, për vëzhgimin e zgjedhjeve për Kuvendin e Shqipërisë, të datës 25 prill 2021".

PJESËMARRJA :

- **KQZ**
1.Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve **Z.Illirjan Celibashi**
2.Stafi KQZ: **Y.Merkaj, M.Koja, V.Ballgjini, E.Allushi**
- **Parti Politike:** **PD, LSI, PDIU**

Z. I. Celibashi: Vazhdojmë me vëzhguesit.

Z. Y. Merkaj: Gjithashtu në KQZ është paraqitur kërkesë nga Misioni ODIHR për akreditimin e 3 vëzhguesve afatgjatë si dhe zonat e vëzhgimit të tyre. Më parë këtij misioni i janë miratuar dhe 13 vëzhgues afatgjatë me Vendimin nr.151 datë 16.03.2021.

Z. I. Celibashi: Miratohet kërkesa e Misionit ODIHR për akreditimin e 3 vëzhguesve afatgjatë.

Vendimi nr. 262

*Zbardhi materialin audio
Silvi SINO*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike së
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.21.04.2021*

**21.04.2021
Ora 14:03**

RENDI I DITËS

**Projekvendim “Për miratimin e vëzhguesve afatshkurtër dhe përkthyesve të
Ambasadës Kroate, Gjermane, Sllovene dhe Italiane, për vëzhgimin e zgjedhjeve
për Kuvendin e Shqipërisë, të datës 25 prill 2021”.**

PJESËMARRJA :

• **KQZ**

1.Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve Z.Illirjan Celibashi

2.Stafi KQZ: Y.Merkaj, M.Koja, V.Ballgjini, E.Allushi

• **Parti Politike: PD, LSI, PDIU**

Z. I. Celibashi: Vazhdojmë me pikën tjetër të rendit të ditës.

Z. Y. Merkaj: Ambasada Kroate ka paraqitur kërkesë për akreditimin e 3(tre) vëzhguesve afatshkurtër si dhe një përkthyesi. Ambasada Gjermane ka paraqitur kërkesë për akreditimin e 4 (katër) vëzhguesve afatshkurtër, si dhe 3 (tre) përkthyesve. Ambasada Sllovene ka paraqitur kërkesën në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve për akreditimin e 2 (dy) vëzhguesve afatshkurtër si dhe një përkthyesi. Ambasada Italiane ka paraqitur kërkesën për akreditimin e 7 (shtatë) vëzhguesve afatshkurtër si dhe 5 (pesë) përkthyesve. Dokumentacioni i paraqitur është në mbështetje në nenin 6 të Kodit Zgjedhor dhe udhëzimi nr.2 të vitit 2021, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Basahkëlidhur keni projektvendimin për shqyrtim dhe miratim si dhe listën e vëzhguesve e përkthyesve, faleminderit.

**Zbardhi materialin e inçizuar
Valbona DUSHI**

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike së
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.21.04.2021*

Z. I. Celibashi: Përfaqësuesit e partive politike kanë ndonjë gjë? Besoj dakord. Miratohet kërkesa e Ambasadës Kroate për akreditimin e 3(tre) vëzhguesve afatshkurtër dhe një përkthyesi.

Miratohet kërkesa e Ambasadës Gjermane për akreditimin e 4 (katër) vëzhguesve afatshkurtër dhe 3 (tre) përkthyesve.

Miratohet kërkesa e Ambasadës Sllovene për akreditimin e 2 (dy) vëzhguesve afatshkurtër dhe një përkthyesi.

Miratohet kërkesa e Ambasadës Italiane për akreditimin e 7 (shtatë) vëzhguesve afatshkurtër dhe 5 (pesë) përkthyesve.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të KQZ-së.

Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në KAS brenda 3 ditëve.

Vendim nr. 263

*Zbardhi materialin e inçizuar
Valbona DUSHI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike së
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.21.04.2021*

**21.04.2021
Ora 14:03**

RENDI I DITËS

Projekvendim “Për një shtesë në vendimin nr. 211, datë 08.04.2021 “Për miratimin e përkthyesve të Misionit të OSBE/ODIHR, për vëzhgimin e zgjedhjeve për Kuvendin e Shqipërisë, të datës 25 prill 2021”.

PJESËMARRJA :

- **KQZ**
 - 1.Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve **Z.Illirjan Celibashi**
 - 2.Stafi KQZ: **Y.Merkaj, M.Koja, V.Ballgjini, E.Allushi**
- **Parti Politike:** **PD, LSI, PDIU**

Z. I. Celibashi: Vazhdojmë me pikën tjetër të rendit të ditës.

Z. Y. Merkaj: Organizata Misioni OSBE/ODIHR, ka paraqitur kërkesën për akreditimin e 3 (tre) përkthyesve. Më parë ky mision nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, ka miratuar me vendim nr.211 datë 08.04.2021 akreditimin e 3 (tre) përkthyesve dhe Misioni OSBE/ODIHR-it ka kërkuar dhe akreditimin e 3 (tre) përkthyesve të tjerë në datën 17.04.2021. Dokumentacioni është në përputhje me Kodin Zgjedhor.

Z. I. Celibashi: Miratohet ndryshimi në vendimin 221, datë 08.04.2021. Në lidhje me akreditimin e vëzhguesve të Misionit OSBE/ODIHR-it, shtohet lidhja 1 sipas së cilës janë 3(përkthyes).

Vendimi nr.264

*Zbardhi materialin e inçizuar
Valbona DUSHI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.21.04.2021*

21.04.2021
Ora 14:03

RENDI I DITËS

Projektvendim “Për miratimin afatshkurtër të Asamblesë Parlamentare të OSBE-së dhe vëzhguesve afatshkurtër dhe përkthyesve të Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës, për vëzhgimin e zgjedhjeve për Kuvendin e Shqipërisë, të datës 25 prill 2021”.

PJESËMARRJA :

- **KQZ**
 - 1.Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve **Z.Ilirjan Celibashi**
 - 2.Stafi KQZ: **Y.Merkaj, M.Koja, V.Ballgjini, E.Allushi**
- **Parti Politike:** **PD, LSI, PDIU**

Z. I. Celibashi: Vazhdojmë me pikën tjetër.

Z. Y. Merkaj: Asambleja Parlamentare e OSBE i ka paraqitur Komisionit Qendror të Zgjedhjeve kërkesën për akreditimin e 67 vëzhguesve afatshkurtër, si dhe zonat e vëzhgimit të tyre. Asambleja Parlamentare e Këshillit të Europës, ka kërkuar akreditimin e 23 vëzhguesve afatshkurtër dhe 16 përkthyesve si dhe zonat e vëzhgimit.

Z. I. Celibashi: Miratohet kërkesa e Asamblesë Parlamentare e OSBE-së për akreditimin e 67 vëzhguesve afatshurtër, si dhe zonat e vëzhgimit të tyre.

Miratohet kërkesa e Asamblesë Parlamentare e Këshillit të Europës për akreditimin e 23 vëzhguesve afatshkurtër dhe 16 përkthyesve si dhe zonat e vëzhgimit.

Vendim nr.265

*Zbardhi materialin audio
Silvi SINO*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.21.04.2021*

**21.04.2021
Ora 14:03**

RENDI I DITËS

Projektvendim “Për miratimin e përkthyesve të Asamblesë Parlamentare të OSBE-së dhe vëzhguesve afatgjatë të OSBE-së, për vëzhgimin e zgjedhjeve për Kuvendin e Shqipërisë, të datës 25 prill 2021”.

PJESËMARRJA :

- **KQZ**
 - 1.Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve Z.Illirjan Celibashi**
 - 2.Stafi KQZ: Y.Merkaj, M.Koja, V.Ballgjini, E.Allushi**
- **Parti Politike: PD, LSI, PDIU**

Z. I. Celibashi: Vazhdojmë me vëzhguesit e tjerë.

Z. Y. Merkaj: Asambleja Parlamentare e OSBE i ka paraqitur Komisionit Qendror të Zgjedhjeve kërkesën për akreditimin e 33 (tridhjetë e tre) përkthyesve për vëzhgimin e procesit zgjedhor për zgjedhjet për Kuvend, të datës 25 Prill 2021 sipas lidhjes 1 bashkëlidhur këtij vendimi.

Z. I. Celibashi: Miratohet kërkesa e Asamblesë Parlamentare e OSBE-së për akreditimin e 33 (tridhjetë e tre) përkthyesve për vëzhgimin e procesit zgjedhor për zgjedhjet për Kuvend, të datës 25 Prill 2021.

Vendim nr.266

**Zbardhi materialin audio
Silvi SINO**

